



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-11877/24  
Kaçanik, 31.05.2024

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **V (pestë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 31.05.2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 24 anëtarë. Në ndërkohë arritën anëtarët: Naim Beça dhe Betim Shala. Në mbledhje mungoj me arsye: Kadrije Lika-Troni. Konstatohet se pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 26 anëtarë.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP, ndërkaq nga zyrtarët: Bejtulla Dalloshi dhe Mavije Murseli, pati edhe zyrtarë tjerë.

Nga OSBE, në mbledhje mori pjesë, Faruk Dërmaku.

Në mbledhje prezantuan: Anëtarë të Këshillit të Muzeut të Qytetit të Kaçanikut dhe nga Rrjeti i OJQ AVONET

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, me arsye mungon Kadrije Lika Troni, me ka njoftuar për mungesën. kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të Kuvendit të Komunës, data 31.05.2024, me këtë:

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Draft Statuti i Muzeut të qytetit të Kaçanikut;
3. Propozim Vendimi për bartjen e të hyrave të tejkaluara nga viti 2023 në vitin 2024;
4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2024;
5. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore nga burimi i fondeve 22 - të hyrat e bartura nga viti kaluar 2023 ne buxhetin e vitit 2024;
6. Rishqyrtimi i Propozim Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Elezaj, në emër të Ndërmarrjes “Migros Group” me përfaqësues Mustafë Rexhepi, në Qirambajtje për 99 vite;
7. Propozim Vendim për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr.104/02-15826/2019 të datës 31.10.2019 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) pronën e paluajtshme

komunale në ZK Kaçanik i Vjetër, Mevlud Zharkut nga Kaçaniku, me vendbanim në Gjermani;

8. Propozim Vendim për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr.104/02-30658/2020 të datës 29.01.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (40 vite) patundshmërinë në ZK Kaçanik i Vjetër, kompanisë "KAÇINKA" L.L.C me NUI 811389429 nga Ferizaj;
9. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "MUJA" OP;
10. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "JLG CONSTRUCTION" SHPK;
11. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.P "X- PLAST";
12. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.SH.T "LYPETENI";
13. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I;
14. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtim të Vendimit 01Nr. 06-350/02-8930/24 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona kadastrale Bob, në emër të Elmaz Mezraja B.I. nga f. Kovaçec;
15. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtim të Vendimit 01Nr. 06-350/02-8928/24 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona kadastrale Bob, në emër të "Dream Palace" SH.P.K. nga Ferizaj, me përfaqësues Avni Etemi.

Pikat 7 dhe 8 janë ndryshuar emërtimet, sepse shkëputjen e kontratës e bënë kryetari i komunës, ndërkaq KK vendosë për shfuqizim të vendimeve. Lidhur me rendin e punës e hapi diskutim:

**z. Agim Mani:** Të pikat 7 dhe 8 keni bërë ndryshim, ndryshimi është dashur me u bërë me kohë, për shkak se ndryshon komplet formati i materialit që e keni sjellë. Për këtë arsye, ne grup i LVV nuk do të marrim pjesë në votim në këto dy pikë, pasi nuk e kemi materialin e duhur.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për sqarim Agim, ka ndryshuar formulimi i emërtimit të pikës, se KK nuk i shkëputë kontratat. KK e bënë shfuqizimin e vendimeve të tij. Përmbajtja e materialit mbetet e njëjtë, pikat duhet të jenë: Propozim Vendim për shfuqizim të vendimit, e jo për shkëputje të kontratës.

**znj. Ardita Rrahmani:** Propozim Vendimet që u potencuan se janë me ndryshime, pika 7 dhe 8, kërkoj me kaluar nëpër filtra të KPF, pastaj me iu adresuar KK. Duhet të kemi të qartë praktikën e këtyre vendimeve, se nuk është hera e parë që njëherë merret vendimi, pastaj kërkon me shfuqizuar atë vendim. Mendimi im është, me shterë debatin në KPF për këto pikë, pastaj me ia adresuar KK, se vendimet në këtë formë mund të sjellin pasoja.

**z. Selajdin Troni:** Unë mendoj se me këtë ndryshim të emërtimit, këto dy pikë të trajtohen në KK, pasi që ne si KK nuk kemi të drejtë me i shkëputë kontratat, por kemi të drejtë me i shfuqizuar vendimet e KK.

**znj. Ardita Rrahmani:** Nuk desha me ndërhyrë, por pasi po bëhet debat, duhet me treguar pozitën tonë në KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sipas LVL, KK ka të drejtë të ndryshoj dhe plotësoj jo vetëm titullin e vendimit, por edhe përmbajtjen. KK është organi më i lartë vendimmarrës, me propozimet në KK mund të bëhen ndryshime në secilin vendim. Ne do t'i trajtojmë kështu, secili e ka mendimin e vet dhe mundet me dhënë. Diskutime të tjera nuk ka, rendin e punës e shtroj në

votim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 3 anëtarë nga LDK, Abstenuan 4 anëtarë nga LVV, nuk morën pjesë në votim 3 anëtarë nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

### **APROVOJ**

#### **Rendin e punës në përbërje prej 15 pikave.**

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush vërejtje në Procesverbal, kërkoj t'i paraqitni:

**z. Betim Shala:** Kam vërejtjet të diskutimi im, vërejtjet do t'i dërgoj me shkrim zyrtares së KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Procesverbalin e mbledhjes se kaluar e shtroj në votim për aprovim me vërejtjen e Betim Shala, dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

### **Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së IV (katërt) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 29.04.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-9223/24.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

#### **Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Ardita Rrahmani:** 1. Nga kontaktet e mia me qytetarë, i paraqes disa kërkesa dhe shqetësime të tyre. Nevoja për rrugë të reja po rritet, ndërkaq buxheti i komunës është i kufizuar, detyrimisht duhen memorandume mirëkuptimi në mes komunës dhe ministrive përkatëse-MMPHI. Ku jemi ne si komunë dhe a kemi ndonjë memorandum bashkëpunimi me atë ministri, nëse po, cilat janë ato projekte të cilat përkrahen?

2. Tek se muajt kalojnë, bashkë me muajt kalojnë edhe diskutimet për PZHK, nevoja për ndërtim dhe zgjerim është e madhe, në mungesë edhe të Hartave Zonale. A ka bazë ligjore të neni 18 të Ligjit për ndërtim, ku përcaktohen kushtet ndërtimore?

3. Në vitin e kaluar kam kërkuar me u bërë emërtimi i "Palestrës së Qytetit", marrë parasysh se Kaçaniku ka shumë kontribut dhënës dhe personalitete të cilët kanë dhënë kontribut ndër vite në sport, shëndetësi dhe arsim. Ku kemi ngecur me emërtimin dhe pse kemi ngecur?

4. Shqetësim tjetër i qytetarëve, Kur do të përfundoj dhe të jetë në shërbim, Ura të ETC, dhe ku kanë ngelë punimet në funksion të nënkalimit?

5. Çka po ndodhë me kubëzat në lagjen: "Ismail Qemali"?

6. E lash në fund, por jo nga rëndësia, se për mua është sa e nevojshme si kërkesë. Nuk është hera e parë që flas në këtë KK as nuk do të jetë hera e fundit, derisa të shoh fillimin e punimeve në shkollën "Emin Duraku". Jemi gati në përfundim të vitit shkollor, ndërkaq nxënës, prindër dhe arsimtarë, po prekën me së shumti. Çka ka konkrete rreth asaj shkolle, ku jemi me letra?

**z. Naim Beça:** Muajin që e lamë pas, e kemi parë një fuqi t 'vogël të natyrës se çka mundet me na bërë. Fjalën e kam për reshjet e fundit atmosferike në komunën tonë, të cilat kanë pasuar me dëme të konsiderueshme. Kjo na tregon se duhet të jemi me tepër të përgatitur për ngjarje të tilla të kësaj natyre. Në urën e Rakocit, ka intervenuar policia atje lartë, për arsye të reshjeve, se ka pasur rrezik të jetës të familjet në atë pjesë. Kërkoj të merren masa për mbrojtjen e atyre familjeve që jetojnë atje lartë dhe që paguajnë taksa, që të rregullohet shtrati i përroit të Rakocit.

**z. Bashkim Luma:** Nuk kam marrë përgjigje në kërkesën të cilën e kam parashtruar të drejtori i Financave, lidhur me shpenzimet që janë realizuar në f. Glloboçicë, në projektet përkatëse,

dhe sqarimin lidhur me krahasimin 2023 2024 të mallrat dhe shërbimet, të pozicioni: Druri dhe prodhimet e drurit.

**z. Agim Mani:** Përgjigjen të cilën e kam marrë nga DUKKMM, pyetja ka qenë, me dërgon projektin për asfaltimin e rrugëve lokale dhe rurale. Përgjigja nga drejtorja; Në rrugët rurale dhe lokale, nuk kemi projekt, punojmë me paramasa. Nuk e di sa është e drejtë të tenderohet një projekt kaq i madh me paramasa. Në kemi pasur vërejtje edhe nga auditori, ndërkaq prapë po veprohet me mendësinë e njëjtë.

**z. Agim Çaka:** 1. Pyetja ime ka të bëjë me shkallët e dëmtuara të halla e sporteve. Pyetja është konkrete. Ato shkallë, a janë dëmtuar në momentin e inaugurimit të objektit, apo janë dëmtuar në ndërkohë. Objekti u inaugurua që 2 vite, ndërkaq shkallët aty janë skandaloze (fjala është për shkallët e jashtme për hyrje në objekt).

2. Një raport i cili është kërkuar për objektin social, pyetja ka qenë konkrete: Cilat kanë qenë parashikimet apo planifikimet lidhur me shpenzimet do të krijohen me përfundimin e atij objekti? Sa ka ndihmuar qeveria, sa ka dhënë mjete komuna, sa kemi dalë jashtë parashikimeve me dhënie e mjeteve, për atë objekt dhe a është në përfundim ai objekt apo ka mundësi që ai objekt deri në përfundim të kalojë 2 legjislatura të KK ? Kjo problematikë është diskutuar edhe në legjislaturën e kaluar, po diskutohet edhe në këtë legjislaturë, kështu që është mirë me na treguar: Sa ka kushtuar në total objekti dhe sa ka dalë jashtë parashikimeve të planifikuara?

**z. Ekrem Livoreka:** Pyetje për DSHPE: Kur do të filloj implementimin i projektit, faza e II e ujësjellësit në f. Ivajë, se me të vërtetë është stërzgatur kjo çështje?

**z. Rrustem Zenuni:** E kam një pyetje për kushte pune të KK, freskimin e sallës nga vapa?

**z. Naim Beça:** Në mbledhjen e kaluar dhe mbledhjet tjera kam bërë pyetje: Sa projekte janë realizuar në komunën tonë. Sa projekte janë nisur në komunën tonë që një kohë të gjatë dhe nuk janë realizuar? Këtë pyetje është hera e katërt që e adresoj, tani po e adresoj të njëjtën.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pyetje dhe Kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën vijuese:

### 3. Draft Statuti i Muzeut të qytetit të Kaçanikut;

Kjo çështje është trajtuar edhe në KPF, KK e ka formuar një këshill, i cili ka pasur për obligim deri në vendosjen e organeve të rregullta të muzeut, të merret me themelimin e muzeut. Prezent i kemi këtu anëtarët e këshillit, besoj se jep përgjigje në pyetje që do të ngritën. Fjalën e ka z. Hajredin Ramajli-Kryesues i këshillit.

**z. Hajredin Ramajli-Kryesues i Këshillit:** Ne si këshill i përkohshëm i themeluar nga KK për funksionalizimin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut, kemi punuar në hartimin e Draft Statutit Muzeut të qytetit të Kaçanikut. Drafti është final, mendojmë se është kompletuar jashtëzakonisht mirë nga çështjet juridike dhe baza ligjore. Nëse ka kush pyetje në këtë akt themelimi, ju lutem na i adresoni.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**znj. Ardita Rrahmani:** Në emër të grupit të LDK të përfaqësuar në KK, e përgëzoj këshillin për punën e bërë. Mendoj se votimi i sotëm do të mbetet në histori të komunës tonë. Jam e lumtur që jam pjesë e këtij KK, ku si grup i LDK do të votojmë aktin e themelimit të Muzeut të qytetit të Kaçanikut.

**z. Rrustem Zenuni:** E përgëzoj këshillin e përkohshëm për punën e bërë për përgatitjen e Draft Statutit të Muzeut të qytetit të Kaçanikut, se është hera e parë që komuna bëhet me aktin e themelimit të muzeut. Akti i themelimit do të jetë historik, i bashkëngjitur diskutimit të koleges Ardita, se Kaçaniku ka histori, ka çka të prezantoj. Të organizimi i mbledhjeve, kërkoj numri i mbledhjeve me pagesë të jetë 6, sikurse komisionet tjera, dhe kjo të bëhet pjesë e aktit.

**z. Hajredin Ramajli:** Është në pyetje fillimi, nëse e votoni draftin, tutje ka me pasur shumë punë, në të ardhmen ju mundeni nga 12 takime, me vendosur për 6 takime, por punë ka me pasur shumë, për atë është vendosur për 12 takime me pagesë. Propozimi i juaj është i logjikshëm për 6 takime për 1 vit.

**z. Selajdin Troni:** Nëse këshilli ka shumë punë, ne mundemi me kërkuar që çështja e kompensimit 12 mbledhje me qenë e përkohshme, që me ndryshuar me vonë, me u kompensuar vetëm 6 mbledhje për 1 vit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Të çështja e kompensimit, jemi duke folur për këshillin drejtues, se këshilli me tepër ka qenë vullnetar. Ka logjikë numri i mbledhjeve me kompensim me qenë 6, se të gjitha komitetet jashtë atyre të përhershme, mbajnë nga 6 mbledhje me pagesë, ndërsa pagesa 100€ për 1 mbledhje për 1 anëtar, mendoj se është në rregull.

**z. Agim Çaka:** Unë mendoj se ky është një hap i dytë shumë i rëndësishëm, për funksionalizimin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut e cila ka qenë kërkesë edhe në legjislaturat e mëhershme. Hapin e parë e kemi bërë ne me themelimin e MQK, hapi i dytë është, Statuti i MQK. Besoj se është bërë planifikimi i duhur i buxhetit, për me funksionuar muzeun. E përgëzoj këshillin për punën që e kanë bërë, besoj se është bërë një punë e mirë, ku janë përfshirë të gjitha pikat në draft statut. Uroj të kemi buxhet për një muze funksional të qytetit të Kaçanikut.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Faleminderit kryesues, shfrytëzoj rastin me iu përshëndet të gjithëve, në veçanti anëtarin e ri të KK, Burim Shehu, se nuk isha pjesëmarrës në mbledhjen e kaluar të KK për me përshëndetë, i uroj punë të mbarë dhe suksese. E përgëzoj këshillin organizativ për një punë të mrekullueshme që e kanë bërë, përkundër vështirësive që kanë pasur në themelimin e një institucioni. Kjo çështje është ngritur edhe me herët, arte fakte ka pasur, tani i erdhi momenti me u themelua Muzeu i qytetit të Kaçanikut. Ndihem edhe unë mirë që para meje kam një këshill që ka bërë një punë të mrekullueshme. Sa i përket kompensimit, siç e tha edhe kryesuesi, ka qenë një rregullore, që përpos komiteteve obligative, komitetet tjera kompensohen për 6 mbledhje në vit. Mund të mbahen me tepër mbledhje, por me pagesë 6, por nëse ju e vlerësoni për shkak të dinamikës së punës dhe rëndësisë së muzeut, nëse jeni të pajtimit për një kohë të caktuar me u kompensuar me tepër mbledhje, unë jam dakord me ju.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Siç e tha edhe kryetari, meqë jemi në fillim të muzeut, dinamika e punës ndoshta ka me qenë me e madhe, deri sa të vendosën në binar puna e muzeut, po e lëmë propozimin ashtu siç është, pastaj në të ardhëm mundem me ndryshuar.

**z. Naim Beça:** E uroj z. Ramajli, për sukseset që i kanë arritur si këshill, për themelimin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut, i cili ka pasur shumë nevojë. I përshëndes të gjithë iniciuesit e kësaj iniciative, besoj se janë duke na përcjellë, i falënderoj për një iniciativë të tillë, ndërkaq i ftoj të gjithë qytetarët e komunës tonë, të gjitha ata që kanë informata apo arte fakte, t'ia ofrojnë këtij muzeu, se përndryshe muzeu nuk mundet me funksionuar pa arte fakte. Për numrin e mbledhjeve 12 mbledhje me kompensim, e përkrahi propozimin, se fillimi është shumë i vështirë në gjetjen e artefakteve, vlerësimin e tyre dhe punët tjera që kanë me i bërë, ndërkaq kërkoj që në këtë komision të anëtarësohen personat që marrin vesh sadopak këtë lëmi. z.

Ramajli e ftoj për bashkëpunim, se LVV është çdo herë në përkrahje për çdo çështje që lidhet me punën e muzeut.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, e shtoj në votim Draft Statutin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Miratimin e Statutit të Muzeut të qytetit të Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 09-104/02-11431/24.**

3. Propozim Vendimi për bartjen e të hyrave të tejkaluara nga viti 2023 në vitin 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, e hapi diskutimin;

**z. Agim Mani:** Me vet faktin që po barten mjetet, të bënë me kuptuar se ka keq planifikim të HVK. Rezervat që janë ndarë për vitin 2024, mendoj se janë rezerva me destinim për çështje emergjente.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Jemi të pika 3, të bartja e mjeteve, jo të rezerva komunale.

**z. Agim Mani:** Na është përzier materiali, se na ka ardhur nga 2-3 herë me ndryshime. Në vitin 2023 ka pasur tejkallim të HVK, në bazë të planifikimit që ka qenë 862,000€, ndërsa realizimi 1 milion e 92 mijë. Tejkallimi i këtyre të HVK ka qenë 230,000€, mirëpo planifikimi për vitin 2023 ka qenë vetëm 862,000€. Të HVK në vitin 2023 nuk janë 1 milion, por 1 milion e 900 mijë, marrë parasysh edhe bartjen e mjeteve nga vitet paraprake, që llogaritën të HVK të pashpenzuara të vitit 2023. Nga 1 milion e 900 mijë, janë realizuar 809 mijë euro, planifikimi ka qenë 862,000€, ndërkaq po barten vetëm 230,000€. Nëse mundesh drejtor na shpjegoni, ku kanë mbetur mjetet tjera që nuk janë realizuar?

**znj. Ernesta Krasniqi:** Po i dëgjoj disa nga drejtorët duke folur prapa shpinës. Nëse ka kush diçka, lë të del para foltores, e jo me fol prapa shpinës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë nuk po i dëgjoj, nëse ka zëra të tillë, kjo realisht nuk duhet me ndodhë.

**z. Bahri Selimi:** Bartja e mjeteve bëhet në bazë të ligjit, ligji ka ndryshuar, ku pjesa e planifikuar është bartë me buxhet, e cila është e barabartë me shumën e planifikuar, 862,000€, ndërsa ajo çka kërkohet sipas nenit 9 të Ligjit të buxhetit pika 7, të HVK të realizuara gjatë vitit 2023 dhe të regjistruara në sistem të ministrisë së Financave, që tejkalojnë të HVK, bartën në vitin 2024. Me herët janë bartë me vendime të KK të gjitha mjetet dhe janë destinuar në programe të caktuara buxhetore, ndërkaq tani bartet vetëm shuma e tejkalluar 230,000€, 115,000€ barten të kategoria e Investimeve Kapitale, të Subvencionet dhe Transferet 90,000€, 25,000 € të Mallrat dhe Shërbimet. Të elementi i realizimit, kemi keqkuptim edhe këtu dhe në KPF, realizimi i të HVK është diku mbi 1 milion e 90 mijë euro, e jo 1 milion e 900 mijë, e cila shumë ka qenë në dispozicion për shpenzim, ndërkaq realizimi i të HVK 2023 është 1 milion e 90 mijë euro, këto mjete minusohen për 860 mijë që kemi arritur me i shpenzuar në vitin 2023, ndërkaq mbesin 1 milion e 90 mijë bilance të pashpenzuara. Shuma 862,000€ janë bartur direkt nga ministria e Financave, ndërkaq tejkallimi i mjeteve është 230,000€.

**z. Agim Mani:** Drejtor, jemi duke bërë bartjen e mjeteve të tejkaluara, 230,000€, planifikimi ka qenë 862,000€, realizimi i krejt këtij planifikimi është kryer. Bartja e mjeteve nga 2022 në 2023 nuk keni pasur as planifikim as realizim, ku kanë ngelë ata mjete? I keni bartur 814,000€,

por çështja është se, ku i keni shpenzuar pa pasur planifikim? Edhe për bartjen e mjeteve nga 2023 në 2024, nuk keni pasur planifikim. Në fund të vitit kanë qenë 1 milion e 900 mijë, i keni realizuar 809 mijë euro.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Keni dalë jashtë temës, jemi duke debatuar për bartjen e mjeteve, 230,000€ të tejkaluara, nga viti 2023 në 2024. Planifikimi ka qenë 862,000€, është rritur për 230,000€ me tepër.

**z. Bahri Selimi:** Për hir të opinionin, ne për çdo vit bartim të hyra. Nuk ka komunë që i shpenzon të HVK 100%, për shkak se ne synojmë që Grantin qeveritar me lëshuar në zero, ndërkaq të HVK kanë fleksibilitet dhe i bartim. Agimi po kërkon pse nuk i kemi të planifikuara bartjet e vitit 2022, nuk mundem me i planifikuar, por kur i kemi bartur nga viti 2022 në vitin 2023 atëherë kemi dal me Propozim Vendim për orientimin e tyre dhe hynë në buxhet për shpenzim dhe se bashku me të HVK të vitit 2023 i kemi në dispozicion. Komuna ka pasur auditim tani dhe opinionin i auditimit është më i miri në nivel kombëtar për raport të auditimit për shpenzimin e parasë publike. Fatkeqësisht komunat tjera që nuk e kanë këtë vlerësim, po zhvillohen me tepër se komuna jonë. Ne po i zbatojmë ligjet, ngelim në zhvillim dhe prosperitet.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kërkoj një sqarim, drejtori me herët i lexoj kategoritë ku do të barten mjetet e tejkaluara, 125,000€ janë në kategorinë e parë, 25,000€ në kategorinë e dytë.

**z. Bahri Selimi:** Mirë e keni ju, por Propozim Vendimi ka pësuar ndryshime, ju jeni duke folur për versionin e parë.

**z. Agim Çaka:** Në vitin 2023 kemi tejkallim të HVK. Është mirë që kemi tejkallim të HVK, por tejkallimi nuk është bërë për ndonjë punë të mirë, zhvillim ekonomik, turizëm, biznes apo aktivitete sportive. Çështja është se këto të HVK na vijnë nga gjobat e gjykatave, policisë. Në aspektin e përgjithshëm, nuk është ky problem i juaj, por po e ngriti si shqetësim, se nuk është mirë komuna me realizuar mjete nga këto që u përmenden dhe me u mburrë për tejkallim të HVK nga këto burime, se kjo nuk është element i mirë me pasur të HVK nga gjobat që i potencova. Sa me pak mjete nga gjobat, kjo është element i mirë edhe për faktorin ndërkombëtar, por edhe për ne, përndryshe këto të HVK janë të lejuara me ligj.

**z. Bahri Selimi:** Propozim Vendimin nuk e kemi dërguar për lëvdatë, sikurse iu referuat ju, por është kërkesë ligjore. Për dallim nga vitet e kaluara, sivjet barten vetëm mjetet e tejkaluara me vendim të KK, pastaj krijohet mundësia për shpenzimin e tyre gjatë vitit që jemi. Në total janë diku 230,000€ nga pozicionet e caktuara, të cilat barten.

**z. Agim Çaka:** Unë fola në përgjithësi se si fenomen nuk është i mirë, shpreha shqetësimin se nuk është mirë për nivelin komunal me pasur shumë mjete nga këto të HVK, jo për drejtorin që e ka sjellë këtu Propozim Vendimin.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në përgjithësi, komuna realizon të HVK direkte dhe indirekte, për indirekte nuk është përgjegjëse komuna fare. Rritja me e madhe e të HVK ka ndodhë të HVK indirekte, që nuk janë pjesë e planifikimit të komunës, nga gjobat e gjykatave, policisë. Neve na imponohet me i trajtuar si çështje, por nuk merremi me ato punë, se ne nuk i shqiptojmë ato masa, janë pjesë e të hyrave indirekte që duhet të bartim dhe me i shpenzuar për të mirën e qytetarëve, që janë të hyra nga gjobitjet e qytetarëve qoftë nga policia apo gjykatat. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 19 votë Për, 6 votë Kundër nga LVV, Abstenoj 1 Raif Kasa –LVV. Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë

## VENDIM

**Për bartjen e të hyrave të tejkaluara nga viti 2023 në vitin 2024, në shumë 230.210.86€ / Lënda: 01Nr.400/01-12552/24.**

4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Bartja e mjeteve qysh në muajin e 5 nga rezerva komunale, nënkupton një keq planifikim. Mjetet rezervë lihen për një qëllim emergjent. Është logjike që mjetet nga rezerva të transferohen në DSHPE për çështje emergjente, e jo mjetet rezervë njëherë të lihen në rezervë, pastaj të shkojnë për investime kapitale. Kjo nuk ka logjikë. Rezervat komunale nuk kanë kod buxhetor, ndërkaq ju i keni koduar në një kod buxhetor dhe po i transferoni në të njëjtin kod buxhetor, në projekte kapitale pa kod buxhetor, kjo nuk është në rregull.

**z. Naim Beça;** Sa është fondi rezervë, sa mjete kanë me mbetur nga fondi rezervë, se me transferin e tyre nuk ngelin asnjë mjet nga fondi rezervë?

**z. Bahri Selimi:** Mjete rezervë janë 25,000€, nuk ngelë asnjë mjet nga ky fond, me transferin e tyre. Kjo rezervë dallon prej nivelit qendror, që ndahen për raste emergjente. Kjo rezervë ka qenë për ndërtimin e një garazhe për ndërmarrjen "Pastërtia". Ministria e Financave e ka klasifikuar si jo të duhur dhe na i ka lënë mjetet në rezervë. Në vitin 2023 i kemi pasur 120,000€ mjete rezervë, janë bartur me vendime të KK, duke u shndërruar në ato kategori që mundën me u realizuar. Nëse këto mjete i lëmë në rezervë, nuk mundën me u shpenzuar askund, për këtë i kemi dërguar në dy projekte, njëra merr kod të ri, tjetra është me kod ekzistues. Rezerva me transferin e tyre më nuk ekziston, presim miratimin e juaj, hiqet rezerva për 25,000€, shtohen Investimet kapitale në shumë 25,000€.

**z. Naim Beça:** Pse nuk i keni planifikuar këto mjete me plan buxhetor se ku kanë me u shpenzuar? A mundën këto mjete me u shpenzuar për raste emergjente?

**z. Rrustem Zenuni:** Ka vite që nuk ka rishikim të buxhetit, dhe ne si KK po detyrohemi me bërë transfere të mjeteve. Pyetje për drejtorin: A ka me pasur rishikim të buxhetit në këtë vit?

**z. Bahri Selimi:** Është viti i 6 apo 7 që niveli lokal nuk ka pasur rishikim të buxhetit, ndërsa në nivel qendror bëjnë rishikim të buxhetit dhe i ridestinojnë mjetet sa herë e shohin të nevojshme, është fjala për ministrinë. Ndërkaq për komuna nuk ka rishikim që sa kohë, për sivjet nuk mundemi me ditur a ka me pasur a jo rishikim të buxhetit, nëse lejohet rishikimi, instruksionet na vijnë diku në qershor apo në korrik. Iu kemi lodhur me transfere, por çështja është, mungesa e rishikimit buxhetor. E falënderoj anëtarin e KK që e ngriti këtë çështje. Ne në këtë formë kemi arritur si komunë për shpenzim me të mirë të buxhetit, kjo është vlerësuar edhe në raport të auditorit.

**z. Naim Beça;** Nuk mora përgjigje se a mundën mjetet nga rezerva me u shpenzuar për raste emergjente? Në rast të emergjencave dhe katastrofave që mundën me ndodhë, a mundem me i tërhequr këto mjete? Pse nuk e keni bërë një kod buxhetor për shtëpinë e zjarrfikëseve?

**z. Bahri Selimi:** Në rast të emergjencave, bëhet me vendime tjera, sikurse vendimi që ka qenë për Covid-19 që janë lejuar mjete.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Naim, të jemi të qartë, mjetet kanë ngelur nga aty, ministria i ka lënë në rezervë, nuk e ka pranuar ministria atë kod buxhetor dhe mjetet i ka lënë në rezervë.



**z. Naim Beça;** Po të kuptoj, por pse mos me i lënë këto mjetet për raste emergjente pasi janë për raste emergjente? Unë e përmenda me herët një rast emergjent, ku ka intervenuar policia.

**z. Agim Çaka:** Edhe unë nuk po e kuptoj sa duhet rezervën komunale. Kur ka raste emergjente, komuna duhet me gjetur mjete me i kompensuar dëmet materiale. Nuk e kam të qartë, komuna, a duhet me pasur rezerva komunale në vazhdimësi, apo jo? Në rast se ndodhin fatkeqësi natyrore, atëherë po duhet me marrë mjete nga projektet e planifikuara, me mbetur ndonjë projekt pa u realizuar, megjithatë komuna duhet me pasur mjete nga rezerva komunale, të cila mjete mundet me u bartë nga viti në vit. Pavarësisht a i vjen momenti me u përdorë, mjete rezervë duhet me pasur komuna, ndërkaq nuk e di a është e rregulluar me ligj kjo.

**z. Bahri Selimi:** Ne, nëse duam me pasur mjete në rezervë, ne kemi mjete të i infrastruktura rrugore e emergjencave, por si fjalë, rezerva ashtu tingëllon, por komunat nuk janë të obliguara me pas mjete rezervë të kjo kategori. Janë 5 kategori ku munden me u shpenzuar mjetet, Pagat dhe Mëditjet, Mallra e Shërbimet, Shërbime Komunale, Subvencionet dhe Transferet, Investimte Kapitale. Kur e kemi dërguar buxhetin me 30 shtator, ka qenë vërejtje e ministrisë shuma 25,000€, nuk është mirë e orientuar dhe na i ka lënë mjetet në rezervë. Mjetet kanë qenë për ndërtimin e depos, ministria e ka klasifikuar jo në kategorinë e duhur, se garazha nuk bënë pjesë në Investime kapitale, na kanë thënë se, ju mund të subvenciononi ndërmarrjen publike. Kuptimin nuk e kanë këto mjete me mbetur rezervë për çështje emergjente.

**z. Naim Beça;** Ky ishte krejt qëllimi i debatit, drejtor.

**z. Agim Mani:** E kuptoj qartë se komuna nuk ka nevojë me ndarë rezervë, i ka ndarë. Nuk ka pasur nevojë me i ndarë 123,000€ në vitin 2022, i ka ndarë pa nevojë. Tani po e kuptoj se rezerva është ndarë pa nevojë dhe mjetet i ka orientuar komuna ku kanë dashur vet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 16 votë Për, 6 votë kundër nga LVV, 3 Abstenime. Raif Kasa nuk ishte prezentë. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë

#### VENDIM

**Për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2024, shuma 25,000€ nga rezerva komunale, transferohen në kategorinë e investimeve kapitale/ Lënda: 01 Nr. 400/01-12092/24.**

5. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore nga burimi i fondeve 22 - të hyrat e bartura nga viti kaluar 2023 ne buxhetin e vitit 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kjo çështje është shqyrtuar edhe në KPF, sipas shpjegimeve, nuk barten të gjitha mjetet, por vetëm ato që nuk janë ridestinuuar në programe të njëjta nga kanë mbetur. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Të pyetjet dhe kërkesat që e bëri Naimi me herët, kodet buxhetore që nuk janë realizuar, na i keni sjellë sot në KK. Këto kode buxhetore të cilat i keni lënë vetëm si kode, për qëllime të juaja, manipulime me qytetarë, këto kode buxhetore tani nuk janë prioritet, ndërkaq në vitin e kaluar kanë qenë prioritet. Këto kode buxhetore nuk i keni realizuar, i keni hequr nga prioritetet tani. Këto mjete duhet të barten në programe të ndryshme në kode të reja buxhetore, por këto kode buxhetore po bartën, si në projektin: Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës” Idriz Seferi’. Pyetja është: A ka përfunduar rruga ” Idriz Seferi’? A po i bartni ende pa përfunduar kjo rrugë, shumën 5,000€? Çka keni me ndërtuar me këtë shumën që po bartet?

**z. Bahri Selimi:** Me arsyetimin e drejtorisë përkatëse DSHPE, shuma 5,000€ për plotësim të kontratës dhe punëve eventuale shtesë, që ende nuk ka përfunduar projekti. Drejtori është këtu për sqarime me të hollësishme.

**z. Ramadush Osmani:** Nevojave për rialokim të këtyre mjeteve, është për zhvillim në terren, lidhur me kontratën e përcaktuar, e dimë shumë e kontratës. Gjatë punimeve në terren, menaxheri i kontratës planifikon dhe has në punë që tejkalojnë ose dalin punë të paparashikuara. Ne si drejtori, për me ardhur deri të vendimi për punë shtesë. Mendoj se duhet të kemi të planifikuar një buxhet shtesë, janë shtuar edhe 5,000€ në bazë të kalkulimeve, i kemi mjetet e Grantit qeveritar dhe mjetet e të HVK.

**z. Selajdin Troni:** Projektet kur të bëhen, të bëhen planifikimi pak me i mirë, në mënyrë që kur të shtohen mjetet, të dimë çka po shtohet, a po rregullohet trotuar, rrugë apo shenja, e jo mos me ditur pse po i shtojmë 5,000€.

**z. Agim Mani:** Edhe unë e bëra pyetje: A ka përfunduar projekti, a keni dalë në vendngjarje me i përcjellë punimet si janë duke u zhvilluar, se ende pa përfunduar punimet rruga është dëmtuar. A është paraparë në këtë projekt, realizimi i ujësjellësit? A keni me toleruar qytetarët me prerë asfaltin e asaj rruge për kanalizim? Ky nuk është shqetësim i imi, por shqetësim i qytetarëve që banojnë aty. E keni bërë një projekt të pakompletuar, nuk keni paraparë as kanalizim as ujë për atë lagje, rruga është plasaritë. Ju vazhdimisht ndani mjete për këtë projekt, projekti nuk ka me përfunduar kurrë, projekti e ka planin dinamik. Çka doni me bërë me kompaninë që i ka kryer punimet dhe menaxherin e projektit, a kanë me pasur ndëshkime?

**z. Ramadush Osmani:** Projekti është në ekzekutim, që i bien që punimet janë në ekzekutim, por nuk janë pranuar teknikisht. Nëse ka plasaritje të rrugës, duhet ditur se a janë për shkak të punës joadekuate të kompanisë, se plasaritjet mund të jenë edhe nga forca madhore, por pjesa tjetër, kanalizimi, kanalizimi atmosferik dhe ujësjellësi në atë rrugë janë të trajtuara. Kanalizimi detal ka qenë ai ekzistues, është funksional, kanalizimi atmosferik është punuar në detaje, ujësjellësi ekziston nga një pikë e caktuar, në pikën tjetër do të vazhdojmë, janë lënë gypat, nuk do të ketë prerje të asfaltit. Mos u bazoni në gjendjen ekzistuese që është plasaritë, se nuk është pranuar teknikisht projekti, njëherë duhet të pranohet teknikisht projekti, komisioni e vlerëson a me u pranua, apo me i kërkuar kompanisë riparime. Edhe pas pranimit teknik, është garancia e sigurimit që kompania i rrinë prapa punimeve që janë defekt i punës së tyre, ndërkaq ato të forcës madhore, janë si rezultat i vërshimeve të mëdha.

**z. Agim Mani:** Për punimin e këtij projekti kanë kaluar procedurat e prokurimit, deri në përfundim të projektit nuk ka nevojë për asnjë mjet shtesë, përpos nëse ka aneks projekt. Ju nuk keni as aneks projekt, vetëm i ndani mjetet, nuk e di në shërbim të kujt jeni, të operatorit apo të komunës, se në këtë rast jeni duke e ndihmuar operatorin, se po ndani mjete? Nëse ka aneks projekt, na e ofroni të njëjtin.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për çdo projekt parashihen edhe mjete shtesë, për defektet që mundën me dalë. Aneks projekt duhet me pasur patjetër.

**z. Ramadush Osmani:** Jam bartës i buxhetit të DSHPE dhe mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i kontratës përmes menaxherit tim. Gjatë punimeve kjo kontratë e ka buxhetin- limitin sa është kontraktuar edhe dinamikën kohore. Gjatë punimeve, menaxheri, e bënë një evidencë. Nëse paraqitet nevoja për aneks kontratë, ajo bëhet në mënyrë ligjore, bëhet kërkesa, nevojat sa duhet me mbuluar punët që dalin në terren. Unë e kam sinjalin që 5,000€ duhet me i pasur për shkak të nevojave që dalin në terren, por nuk do të thotë të ekzekutohet pa u lidhur aneks kontrata.

Projekti nuk mundet të ngelë në gjysmë, për shkak të nevojave që paraqitën në terren. Unë jam në shërbim të kryetarit, e jo të kompanisë.

**z. Agim Mani:** Këto mjete po i bartë në kod buxhetor, ndërkaq kodi i projektit ka kod tjetër. Nëse ju nuk keni bërë aneks projekt, ju e keni edhe planifikimin, tenderi ju ka ra nën planifikim 10% lejohet, ku i keni mjete? Kjo tregon për planifikim jo të mirë. Është edhe memorandumimi me qeverinë, për atë që ka shkelje, nuk bëhen standarde, qeveria nuk i bënë më projektet.

**z. Ramadush Osmani:** Mjetet po i kërkoj, për shkak se nuk po mbulon me realizuar projektin.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Projekti është i qeverisë, qeveria është duke e mbikëqyrë projektin.

**z. Agim Çaka:** Në terminologji profesionale drejtor nuk kemi njohuri të mjaftueshme, si rialokim, bartje, transfere. Këto i lejon ligji me u bërë, por çështja është, ne po themi planifikimi nuk është duke u bërë i mirë. Kur të miratohet buxheti, bëhet në bazë të planit, por rrugës së ekzekutimit po dalin çështja e rialokimeve, bartjes, transfereve, se kur planet nuk bëhen si duhet, po lindë ka nevoja me intervenuar në këtë formë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Këto janë relevante, se me një projekt që është bërë planifikimi i një buxheti me shifër të caktuar, në shumë raste kompanitë hyn me çmim me të lirë dhe mbesin mjete, dhe ato mjete barten. Ka projekt që nuk mund të planifikohet saktë, se gjatë punimeve dalin punë dhe duhet shtuar mjete. Kjo është relevante sikurse që mbesin mjete ashtu edhe me u shtuar mjete, për punë të paparashikuara.

**z. Agim Çaka:** Unë nuk thashë që mos me ndodhë, por mos me ndodhë shpesh, se në kushte normale dhe ku punohet, ndodhin këto çështje.

**z. Bahri Selimi:** Me herët e bartëm vetëm diferencën, ndërsa të shuma tjetër mbi 700,000€ i ka alokuar ministria edhe në kode të cilat nuk ekzistojnë. Me ligjin e buxhetit, mjetet janë bartë automatikisht, me mundësinë me i rialokuar përmes propozim vendimeve. Ky rialokim ka të bëjë vetëm me DSHPE, se edhe pse i ka bartë ministria në formë automatike, diku zënë vend, në projektet që janë, fjala vjen të projektet 2 vjeçare, por ka projekte që ministria i ka bartë mjetet në kode pasive, në projektet ku kanë mbetur. Ne, përmes propozim vendimeve kemi me kërkuar që ato mjete me u ridestinuuar, me u shpenzuar sivjet, për shpenzim sa me të lartë të buxhetit.

**z. Ekrem Livoreka:** A do t'iu epët leje e veçantë kompanive transportuese për Han të Elezit?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Jeni jashtë teme, është dashur të pyetjet dhe kërkesat. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 15 votë për, kundër 5 anëtarë nga LVV. Abstenuan 5 anëtarë (4 nga LDK dhe Raif Kasa). Bashkim Luma nuk ishte prezentë kur u votua kjo pikë. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë

#### VENDIM

**Për rialokimin e mjeteve buxhetore nga burimi i fondeve 22 - të hyrat e bartura nga viti kaluar 2023 në buxhetin e vitit 2024/ Lënda: 01Nr. 400/01-11717/24.**

6. Rishqyrtimi i Propozim Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Elezaj, në emër të Ndërmarrjes "Migros Group" me përfaqësues Mustafë Rexhepi, në Qirambajtje për 99 vite;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ky Propozim Vendim ka qenë edhe një herë në KK, i është kthyer në rishqyrtim propozuesit se nuk ishin të sakta të dhënat. Defektet janë eliminuar nga komisioni

profesional. Edhe pse janë duke na kthyer vendimet e kësaj natyre, po i trajtojmë këto çështje, për shkak të ngecjes së PZHK. Shqetësuese është se, kemi raste kur përgjigje kthehet pas 3-4 muajve. Një përgjigje është kthyer pas 3-4 muajve për një vendim të miratuar në dhjetor 2023 fjala është për pronën e Mensur Dullovi dhe një tjetër vendim na është kthyer diku pas 2 muajve, është fjala për pronën e Samedin Rexha. Tani i kemi edhe 2 vendime që janë kthyer, por janë në kohë. Vendimet që është vonuar vlerësimi i ligjshmërisë, nuk i kemi sjellë për shfuqizim se kanë hyrë në fuqi, vlerësimi i tyre është jashtë afatit, ndërsa këto dy tjera janë në afat dhe do t'i shfuqizojmë. E hapi diskutimin:

**z. Betim Shala:** Sipas PZHK kjo është tokë bujqësore, mendoj se edhe kjo lëndë ka me u kthye në rishqyrtim si ato tjerat. Është dashur me shikuar ndonjë formë tjetër me ia ndërruar destinimin, përndryshe kemi me pasur si pikë në mbledhjen vijuese me shfuqizuar këtë vendim.

**z. Agim Mani:** Pajtohem me parafolësin, flitet për parcelën e klasës 6 dhe 5, ndërsa me fletë poseduese është e klasës 3, e që nuk është potencuar. Fletë poseduese e dëshmon se prona është shoqërore dhe prona është në peng marrje –hipotekë. A keni kërkuar me i ndihmuar që të investohet, apo nuk doni me kaluar, po doni me iu ikur përgjegjësisë, se duhet ndjekur në formë të qartë veprimet që duhet me i marrë për biznesin në formë shumë profesionale. Nëse prona është pengmarrës, çfarë të drejte kemi ne me marrë hapa tjerë. Flitet që kjo parcelë është e ndarë, deri me 31 korrik është në peng marrje, dhe ne nuk mund të bëjmë asgjë, pa u kryer procedurat për pronën në peng marrje, pa e dhënë një pëlqim banka se është liruar nga peng marrja. Banka ka kontratë me operatorin për peng marrje, nëse nuk i kryen borgjet, atëherë banka ta merr pronën. Ne, a jemi duke ndihmuar bankën apo operatorin?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne i kemi këto problemet tjera, ndërkaq çështja me bankën është çështje tjetër, për arsye se banka e lënë në hipotekë pronën, por banka nuk të pengon me ndërtua dhe me u zhvillua, ndërkaq nuk mundesh me ia dhënë dikujt tjetër pronën e lënë në hipotekë.

**z. Qamil Stagova:** Nëse kalon shqyrtimi në ministri, banka duhet me dhënë pëlqimin me proceduar tutje. Në këso raste banka ka dhënë pëlqime. Është fjala për prona private që nuk kemi pasur nevojë me proceduar në KK. Gabimet kanë qenë të natyrës teknike, prona është për energji të ripëritshme, shpresoj të kaloj edhe në ministri.

**z. Agim Mani:** Unë mendoj se duhet me pasur pëlqimin nga banka kompania, me përgatit dokumentet e nevojshme, pastaj me na sjellë neve në KK, e jo me na ardhur lënda kështu e mangët.

**z. Qamil Stagova:** Pëlqimin pronari e ka nga banka.

**z. Agim Mani:** Unë nuk po shoh se ka pëlqim nga banka.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kërkesa është për ndërrim destinimi të tokës e jo për leje ndërtimore. Në momentin që ai kërkon leje ndërtimore, këta kanë me ia kërkuar të gjitha dokumentet e nevojshme që e kërkon ligji. Në jemi duke pasur problem PZHK të ri, edhe pse destinimi i kësaj prone është shumë e leverdishme. Ne po e kryejmë punën tonë, derisa kemi ngecë në PZHK, ne duhet me iu bërë zgjidhje palëve, nëse na kthehet vendimi, e shfuqizojmë.

**z. Agim Çaka:** Ne po mundohemi me iu kryer shërbim qytetarëve, ne nuk jemi profesional. vendimi shkon në një nivel tjetër për vlerësim se a është i ligjshëm apo jo. Praktika e ka treguar se shumë vendime që i kemi marrë këtu që janë në interes të qytetarëve, na i kanë kthyer në nivelin qendror, se janë në sh përputhje me ligjin. MAPL vendimet po i dërgon në ministrinë e linjës, në këtë rast në MBPZHR, ndërkaq kjo e fundit po i refuzon, se nuk janë në harmoni me

ligjin. Krejt këto janë pasojë e mungesës së PZHK. Sa do të zgjatë kjo dhe a ka rrugë tjetër me iu bërë zgjidhje qytetarëve me ecur përpara? Ky është shqetësim i madh, se nuk është e mjaftueshme që ne po marrim vendime të tilla, por puna nuk po kryhet se vendimet po na i kthen ministria.

**znj. Ardita Rrahmani:** Kjo pikë e kësaj natyre nuk është e para as e fundit. Çështjet po na adresohen këtu, besoj se do të votohet, ndërkaq mesazh i shkon palës se kjo çështje kalon. Pala mendon se është krejt në rregull, ndërkaq mesazhi tjetër që kthehet prej ministrisë nuk i shkon palës. Iu bëjë thirrje nga kjo foltore si ekzekutivit dhe nivelit qendror t'i kthejnë përgjigjet, lë të bëhet PZHK, se krejt kjo po vjen si pasojë e mungesës së PZHK, se kur e kemi PZHK, Hartat zonale, atëherë shterën mundësitë për debat. Unë pres me padurim me pa numrin e popullsisë të banorëve, me shikuar se çka kemi me diskutuar me numrin e banorëve në Kaçanik, uroj të del shifra 30,000 banorë të komunës tonë.

**z. Rustem Zenuni:** Prej kujt iu ka ardhur mesazhi Ardita, se ne dërgojmë palës mesazh nga këtu? Është mirë me thënë konkret me ditur kush dërgon mesazhe.

**znj. Ardita Rrahmani:** Gjithsecili, përfshirë edhe vetën time. Seancat janë të drejtpërdrejta dhe secila palë që ka interes dhe e dinë se pika ka me u trajtuar, normal në kushte normale ishte dashur me lëshuar në Youtube punimet e seancës dhe me përcjellë se çka po ndodhë me pikën që ai e ka interesin. Në anën tjetër, në momentin që kalon apo nuk kalon, është obligim që administrata me ia dërguar palës se çka po ndodhë, se përveç mesazhit, unë nuk e di se me çfarë mënyre komunikoni ju me palën.

**z. Rustem Zenuni:** Ne e dimë se çka duhet me bërë komuna, ndërkaq për metoda tjera – mesazhet, ndoshta ju i bëni, unë nuk e di. Për mua me rëndësi është që, qytetarit dhe çdo kush që është i interesuar, me iu krijuar qasje, me ditur se çka po bëhet, ndërkaq a i shikon apo jo pala, ajo është çështje tjetër.

**znj. Ardita Rrahmani:** Mesazh për mua është edhe komunikimi përmes emailit zyrtar, mesazhi përmes telefonit, që ia komunikon informatën palës së çka po ndodhë.

**z. Agim Mani:** E potencova edhe në fillim që investitorit duhet me i dhënë këshilla profesionale. Është mirë që investitori ka shprehur vullnet me investuar shuma milionëshe, se është mirë për qytetarët e komunës, por duhet t'ia krijojmë infrastrukturën, e jo të kalojmë në këtë formë, pastaj gjatë realizimit pala të has në pengesa, sikurse e potencove kryesues për vendimet të kësaj natyre që kanë marrë miratimin në KK, ndërkaq me vonë, pas 2 muajve kthehen të kundërligjshme, ndërkaq në anën tjetër operatori ka filluar me zhvilluar biznesin.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë e thashë se vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore që është kthyer nga ministria, njëri është i muajit dhjetor 2023, konfirmimin e kemi marrë para 2-3 javësh jashtë çdo afati ligjor. Afati ligjor i MAPL është 15 ditë, sikurse këto 2 që i kemi sot. Ligji e thotë qartë, nëse nuk ka konfirmim të ligjshmërisë, vendimi publikohet dhe hynë në fuqi në afatin e përcaktuar ligjor, pastaj vazhdohet me procedurat tjera, si pala e bënë pagesën. Ku është përgjegjshmëria e nivelit qendror në këtë rast për lëshimin e afateve ligjore. Nuk është çështje e imja, se është në kompetencë të organit propozues a me sjellë vendimin në rishqyrtim apo jo. Qysh mendoni se duhet me rishqyrtuar një vendim pas 5-6 muajve, edhe nëse rishqyrtohet, propozimi rrjedhë prej Kryetarit të Komunës. Kjo problematikë është e kahershme me disa ministri të linjës, ndërkaq me MAPL nuk kemi problem, problemi është me MBPZHR dhe MMPHI. Si do që të jetë, ne i respektojmë procedurat e përcaktuara me ligj.

**z. Agim Mani:** Për personin që e potencove që iu ka lejuar ndërrimi i destinimit, kur është marrë vendimi, punimet kanë qenë në gjysmë të projektit. Çka do të bëhet nëse nuk shfuqizohet një vendim i tillë, kush do të merr përgjegjësinë, se janë lejuar punimet, është ndërprerë puna, për atë unë po e themi në start, të kemi kujdes në këto çështje.

**Kryetari i Komunës:** Arsyeja, jo pse ne e kemi vullnetin me i votuar këto çështje, kemi ngarkesa dhe presione, se jemi në shërbim të qytetarëve. Ardita tha se nuk e di a do të dalin 30,000 banorë, është shumë e vërtetë, palët po me adresohen mua, duke me thënë se ju po na dërgoni në Ferizaj se atje po ndërtohet, ndërkaq këtu nuk po lëshoni leje. Në temën në fjalë që po e diskutojmë, ka qenë ajo pronarja për vendimin që kemi me rishqyrtuar, i kam thënë se me PZHK nuk është e paraparë, me ka thënë kryeni ju punën e juaj, ndërkaq pjesa tjetër me takon mua. Të PZHK nuk po themi se nuk kemi gabime, jemi munduar duke marrë këshilla edhe prej opozitës, LVV nuk e ka pa të arsyeshme me na ndihmuar, jemi munduar me kapacitetet që i kemi, e kemi bërë draftin dhe është dërguar në ministri. Çështja është se, kur e merr raportin për PZHK, me na thënë me plotësuar pikat ku i shohin të metat. Si veprojnë ata, nëse pika e parë nuk është në rregull, na e kthejnë krejt dokumentin, edhe pse e plotësojmë, bile ata duhet me na dhënë edhe këshilla juridike, se janë e ekspertë dhe e pranojmë atë se janë me ekspertë, nëse është nevoja me ardhur edhe këtu në komunë, por këtë nuk e ka bërë asnjë qeveri. Të PZHK, me tregoni ju kjo autostradë në Kaçanik çfarë plani zhvillimor ekonomik e ka respektuar, megjithëse ka qenë interes nacional, plotësisht jam pajtuar. Të kjo është interesi nacional edhe lokal, për atë e kam adresuar në KK. Me pas qenë me PZHK, nuk ka pasur nevojë me ardhur këtu fare. Unë i kam treguar se nuk kalon në ministri se nuk është me PZHK. Kemi me ardhur edhe në situata të tjera, po shohim për komunat tjera janë ndërtuar ndërtesa me 20 kate, 100-200 objekte, se për dikën MAPL po i mbyllin sytë, ndërkaq në Kaçanik një e kemi, edhe ajo është në hetuesi. A duhet me iu ndihmuar qytetarëve e me u penalizuar unë, apo si me vepruar. Për atë jemi munduar me bërë PZHK, por kemi mbetur peng, ne planifikojmë me i bërë këto ndërrime destinimesh që me iu dhënë qasje qytetarëve, me iu ndihmuar, ana tjetër na ka ngecë PZHK. Nuk po e përjashtoj që edhe ne kemi të meta, megjithatë nuk është gjetur ndonjë zgjidhje me iu ndihmuar qytetarëve. Kemi me pasur edhe raste tjera, e potencova, por kemi ardhur në një pozitë që nuk di si me vepruar, ndërkaq nëse ka ndonjë alternativë, lirisht mund të thoni, jam me pranuar çdo ide të mirë, se jemi këtu në shërbim të qytetarëve. Me kapacitetet që i kam këtu dhe me këshilltarët e mi që e njohin atë lëmi, nuk po gjejë rrugëzgjidhje, të meta kam nuk e përjashtoj, kjo është mundësia, përderisa nuk e kemi PZHK kemi me ardhur në të njëjtën situatë. Ne jemi duke dërguar në vazhdimësi shkresa, kemi kontakte me zëvendësministrat, por ndoshta edhe ai nuk e ka fuqinë, por nuk po mundemi me tejkalar këtë situatë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Uroj që kjo mos të shfrytëzohet për poena politike.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk besoj se ka interesa politike këtu, se na po ndëshkohemi, se nuk fitojmë poena politik duke na u kthyer vendimet prapa.

**z. Bashkim Luma:** Po e ngriti si shqetësim në emër të LVV, se kur juve iu shkon për interes diçka një çështje me dalë jashtë rendit të punës, qoftë LDK apo PDK, ia arrini qëllimin, ndërkaq kjo nuk është në rregull me ia gjuajt fajin LVV. Kryetari e potencoj se LVV nuk ka qenë bashkëpunuese në çështjen e PZHK.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë dhe ti Bashkim jemi kolegë, dhe nuk e di se cila është fuqia ime me dalë jashtë rendit të punës, kryesuesi e udhëheqë mbledhjen. Nuk keni të drejtë me thënë LDK po del jashtë rendit të ditës së LDK është opozitë sa jeni edhe ju LVV.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse flasim se kush del me tepër jashtë rendit të punës, janë procesverbalet, janë incizimet, por të jeni të bindur se LVV del me së tepërmi, por nuk e kam shikuar shumë këtë çështje, kam qenë tolerantë. Në këtë çështje nuk e akuzoj askënd që del jashtë rendit të ditës, se u diskutua për PZHK, kryetari e potencoj punëtorinë e mbajtur, dhe ju –LVV nuk keni qenë pjesëmarrës. Kryetari e theksoj se e respektojmë vendimin e LVV, në rregull jemi për këtë çështje. Ne edhe si KK jemi munduar me dhënë të paktën një kontribut për PZHK.

**z. Bashkim Luma:** Ka raste kur mund të dilet jashtë rendit të ditës, por jo në atë formë, me fol kundër dikujt.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk foli askush kundër dikujt.

**Kryetari i Komunës:** Është e vërtetë se dolëm nga rendi i ditës, por u diskutua çështja e PZHK. U ndërlidha me tepër me këtë çështje, nëse me kuptuat, janë incizimet, absolut nuk iu akuzova. Unë e potencova se ata që kanë pasur vullnetin kanë dhënë kontribut, ju nuk e keni pasur vullnetin, e respektoam vullnetin e juaj. Nuk kam thënë asgjë me tepër, me pas pasur vullnet, na kishit ndihmuar në këtë drejtim, unë thashë vullneti i juaj ka qenë ashtu dhe e kam respektuar.

**z. Bashkim Luma:** Kontribut mundesh me dhënë kur ke mundësi me arritur një rezultat. Nëse nuk ke mundësi me dhënë kontribut, nëse nuk je përgjegjës për atë fushë, nuk mundesh me dhënë kontribut.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ai është vlerësim i juaji, sepse secili qytetarë aq me tepër anëtarët e KK e kanë obligim, se është një dokument që ka me ardhur në KK me marrë miratimin. Ne kemi dashur që paraprakisht me pasur një qasje në atë dokument, që mos t'na vjen direkt në KK për miratim, nuk ka qenë ide e keqe.

**Nënkryetari i Komunës:** Për PZHK, emaili iu ka drejtuar ministrisë me 22.08.2023, nga Qamil Stagova, zyrtarëve kompetent për PZHK, CC ministrit: Liburn Aliu, për shqyrtim të VSM që i paraprinë PZHK. PZHK si dokument është i gatshëm, por pa na e kthyer përgjigjen për VSM, nuk mundemi me shkua tutje. Ata e kanë pa të arsyeshme me 05.01.2024 me na kthe përgjigje për këtë, jam edhe unë CC. Me 5 janar u bënë 6 muaj, na kanë sjellë një njoftim se komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për VSM është duke u trajtuar aplikacioni për vlerësim strategjik mjedisor në vazhdimësi dhe ju e dini se shqyrtimi i një aplikacioni merr kohë të konsiderueshme. Aplikacioni i juaj është trajtuar njëherë dhe ne keni kërkuar informata shtesë, i kemi pranuar në formë elektronike, por për shkak të ngarkesës, stafit me numër të konsiderueshëm të kërkesave, punët të tjera të përditshme, ne do të mundohemi t'i kthejmë përgjigje sa me parë kërkesës së juaj. U bë bukur një kohë -gati 1 vit që ne po presim PZHK me hartuar dhe procedurat e debatit me qytetarë. A është mirë apo keq, ne po presim atë përgjigje, Kryetari e tha me herët se, po t'na kishin kthyer përgjigje në bazë të afateve ligjore, për çdo pikë veç e veç e kishim arritur afatin, por çështja është se 1 herë në gjashtë muaj na kthejnë përgjigje.

**z. Agim Mani:** Nënkryetari e potencoj se ne iu kemi dërguar kërkesë për përgjigje në vitin 2023 me shkrim për vlerësim. Ju e dini që PZHK ka përfunduar në vitin 2018, pas 5 viteve keni dërguar ju në vlerësim. Në vitin 2019 është dashur me qenë plani i gatshëm. Ju jeni duke folur pas 5-6 viteve vonesë dhe përsëri mundoheni me arsyetuar vetën tuaj.

**Nënkryetari i Komunës:** Çështja e PZHK mundet me u kërkuar me qenë pikë e veçantë në KK, por e ndjeva për obligim me ua sqaruar, se Ardita tha: mos po e shfrytëzoni për poena politik. Krejt çka e theksova, mundem me ua printuar dhe me ua ofruar.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë thashë, uroj të mos shfrytëzohet për poena politik.

**z. Naim Beça;** A mundem me pasur pikë të veçantë çështjen e PZHK?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne jemi për me bërë zgjidhje për ne dhe për qytetarë, çështjet tjera i lëmë. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 16 votë për, Kundër 8 anëtarë (5 nga LVV, 3 nga LDK) Abstenim 1. Prezentë 25. Besnik Salihu nuk ishte prezentë kur u votua kjo pikë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë

#### VENDIM

**Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Elezaj, në emër të Ndërmarrjes “Migros Group” me përfaqësues Mustafë Rexhepi, në Qirambajtje për 99 vite/ Lënda: 01Nr. 350/02-11622/24.**

7. Propozim Vendim për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr.104/02-15826/2019 të datës 31.10.2019 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) pronën e paluajtshme komunale në ZK Kaçanik i Vjetër, Mevlud Zharkut nga Kaçaniku, me vendbanim në Gjermani;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Këtij Propozim Vendimi i kanë paraprirë edhe dy raporte që kanë qenë me herët në KK. Të titulli, titulli është ndryshuar, ndërkaq përmbajtja e vendimit mbetet e njëjtë, së KK nuk merret me shfuqizim të kontratave, por merret me shfuqizimin e vendimeve që i ka marrë. Kryetari është këtu, drejtori është këtu, e hapi diskutimin:

**znj. Ardita Rrahmani:** Në emër të LDK po flas, ju e thatë se lënda ka ndryshuar në titull, por ne si LDK mendojmë së lënda ka ndryshim substancial nga kërkesa për shkëputje të kontratës në kërkesën për shfuqizim të vendimit të KK për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Çështja të kalon fillimisht në procedura, pastaj t ‘na vjen në KK. Ne si LDK nuk marrim pjesë në votimin e kësaj pike.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse e lëmë si në KPF, atëherë Propozimi është për shfuqizim të kontratës.

**znj. Ardita Rrahmani:** Lënda me këto ndryshime fillimisht lë t ‘na vjen në KPF.

**Kryesuesi i Kuvendit:** KK e ka fuqinë me ndryshuar dhe plotësuar lëndën.

**z. Agim Mani:** Është e vërtetë se KK mundet me ndryshuar, se i ka numrat, KK e jep në shfrytëzim pronën, KK e shfuqizon vendimin, por forma qysh e ka dhënë, me të vërtetë është e pakuptueshme. Në një zonë industriale, një kontratë që e ka lidhë kryetari i komunës me operatorin ekonomik Mevlud Zharku me një projekt ideor, jo të detajuar, se projekti ideor mundet me u ndryshuar dhe ka arritur me u ndryshuar. Kontrata e lidhur mes Kryetarit të komunës dhe Mevlud Zharku ka qenë që në atë parcelë, në atë zonë industriale të ndërtohet një betonjerkë, autolarje. Unë kam qenë pjesë e KK nga fillimi, po flas në bazë të kontratë, në një zonë industriale të ndërtohet edhe betonjerkë edhe hoteleri, kjo është e pakuptimtë, se nuk kanë mundësi këto në një vend, për atë nuk ka mundur me realizuar dhe nuk mundet me realizuar se bien ndeshë me urbanizmin. Gjatë lidhjes së kontratës me operatorin, përveç këtyre raporteve, mbikëqyrja e kryetarit nuk ka qenë absolut, që është dashur me përcjellë planin dinamik pas 6 muajve, ndërkaq operatori pas 1 viti e ka ndërruar numrin e biznesit dhe e ka shitur apo huazuar, ia ka dhënë vëllait të tij, ndërkaq vëllai i tij i ka shitur pajisjet e betonjerkës. Masat



është dashur me u marrë me kohë, se me i pa marrë masat me kohë, tani nuk ishin mbetur disa punëtorë pa punë. Faji është i ekzekutivit, ndërkaq me së paku faj kanë punëtorët. Sipas Ligjit 06/L-92 kryetari i komunës ka lidhë kontratë, pika 22.7 thotë: Në rast të mosrealizimit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke tejkalluar afatet e përcaktuara në kontratë, kryetari i komunës merr vendim për shkëputje të kontratës dhe me këtë vendim e njofton KK. Çfarë kuptimi ka tani në si KK të shfuqizojmë një vendim të tillë, kur kontrata është në fuqi.

**z. Selajdin Troni:** Komisioni e ka thënë se nuk është bërë ndërrimi i pronarit, teorinë konspirative se çka ka me u bërë pas 100 vjetëve, ajo është diçka tjetër. Raporti ka qenë shumë i mirë dhe të gjithë jemi pajtuar. Ne po ia marrim tani pronën, ndërkaq lë të jetë ky një mesazh për krejt pronat që epën në shfrytëzim, jepen për zhvillim ekonomik, për punësim, lë të jetë mesazh se nuk mundet dikush me marrë pronë komunale në shfrytëzim e me i mbajë peng, e me ua ndërruar dëstinimin, që me përfituar vet. Për këtë, kjo çështje ka ardhur në KK dhe me vjen mirë që ka ardhur në KK. Për pronat e dhëna në shfrytëzim, përsëri duhet me punuar komisioni, për me i mbikëqyrë pronat se a janë duke iu përmbajtur rregullave të planit të biznesit. Kuvendi e jep pronën në shfrytëzim, kuvendi ia merr të drejtën e shfrytëzimit.

**z. Agim Mani:** Komisioni është formuar në vitin 2023, 4 vite ka qenë pa mbikëqyrje kompania, ndërkaq faji nuk është i KK, por i Ekzekutivit. Prona është dhënë në shfrytëzim, por nuk iu ka përmbajtur procedurave për mbikëqyrje të kontratës, mos ia hidhni faji KK se KK me së paku ka faj në këtë drejtim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse merret vendimi për dhënë në shfrytëzim të pronës komunale, KK e shfuqizon atë vendim, se përgjegjësia është e KK, ndërkaq fajin nuk po ia hedhim KK për mbikëqyrje të kontratave, kjo është në përgjegjësi të kryetarit. Tani është sjellë në KK propozimi për shfuqizim të vendimit, kryetari pastaj me e shkëputë kontratën. Se qysh duhet me u trajtuar kjo çështje, e thotë qartë neni 27 i ligjit. Rregullorja e thekson edhe me qartë çështjen e shkëputjes së kontratës.

**z. Agim Mani:** Kryetari nuk e ka marrë për bazë rregulloren, por ligjin për shkëputje të kontratës, operatori në këtë rast ka të drejtë ankese.

**z. Qamil Stagova:** Çështja thelbësore është: A po ia marrim operatorit ekonomik atë pronë që ia ka dhënë komuna apo jo? Ligi dhe rregullorja kanë mospërputhje në mes vetë, por ne kemi vendosur me aplikuar këtë formë. Si të bëhet vendimi i plotfuqishëm, ne vazhdojmë me punët tjera.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori e ka sjellë si Propozim Vendim për shkëputje të kontratës, unë nuk kam pranuar, për shkak se është në përgjegjësi të KK shfuqizimi i vendimit, ndërkaq për shkëputje të kontratës është në përgjegjësi të kryetarit të komunës. KK e obligon kryetarin me e shkëputë kontratën, se edhe prona kur është dhënë në shfrytëzim, fillimisht është marrë vendimi, pastaj është nënshkruar kontrata.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kërkoj nga Kryesuesi i KK të lexoj nenet ku është e përcaktuar procedura për shfuqizim të kontratës dhe shkëputje të kontratës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mundem me të dhënë ligjin dhe lexoje, çështja se kush ka të drejtë, janë organet që e vlerësojnë.

**z. Rrustem Zenuni:** Kërkoj të respektohen rregullorja e punës së KK gjatë diskutimeve, se po bëhet shumë zhurmë. Shkëputjen e kontratës e bënë kryetari i komunës se kur e ka lidhë

kontratën me operatorin, asaj kontrate i ka paraprirë vendimi i KK. Tani edhe në këtë rast, kontratës për shfuqizim, është duke i paraprirë vendimi i KK për shfuqizimin e vendimit të KK për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

**z. Agim Mani:** Kontrata është nënshkruar bazuar në ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Vendimi i KK është për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Qëllimi është të operatori ekonomik, operatori ekonomik nuk pajtohet dhe e procedon çështjen në prokurori, dhe lënda mund të përfundoj në krime ekonomike dhe të uzurpohet toka, sikurse toka e objektit të banimit social.

**z. Agim Çaka:** E kam lexuar edhe ligjin edhe rregulloren dhe kam ardhur këtu me njohuri të plota. Çështja është se, Propozim Vendimi për shkëputje të kontratës, nuk është dashur me na ardhur në këtë formë, lënda ka ardhur që 8 ditë dhe nuk keni reaguar. Pyetja ime e parë është: Pse nuk keni reaguar, me përmirësuar në ndërkohë? Procedurat e ndërprerjes e kontratës, realizohet pas marrjes së vendimit nga KK për shfuqizimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Në aspektin juridik, unë nuk e di se a duhet fillimisht me u anuluar kontrata, pastaj me u shfuqizuar vendimi, kryetari e vendosë atë punë. A është dashur kryetari paraprakisht me pasur informacione për shkëputje të kontratës, me shkëputë kontratën dhe me ardhur me një njoftim dhe për arsye të shkëputjes së kontratës nga kryetari, ne me marrë një vendim për shfuqizimin e vendimit. Për këtë arsye për shkak të ndryshimeve të cilat kanë ardhur në moment të fundit, qofshin teknike apo thelbësore, nuk do të votoj votim këtë pikë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, Propozim Vendimin për shfuqizimin e vendimit të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 14 votë Për (12 nga PDK, 2 nga AAK), Kundër votë nuk pati, Abstenuan: Raif Kasa dhe Agim Çaka. Nuk morën pjesë në votim 9 (6 LVV, 3 LDK). Besnik Salihu nuk ishte prezentë kur u votua kjo pikë. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr.104/02-15826/2019 i datës 31.10.2019 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) pronën e paluajtshme komunale në Zonën Kadastrale Kaçanik i Vjetër, Mevlud Zharkut nga Kaçaniku, me vendbanim në Gjermani/ Lënda: 01Nr. 104/02-11634/24.**

8. Propozim Vendim për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr.104/02-30658/2020 të datës 29.01.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (40 vite) patundshmërinë në ZK Kaçanik i Vjetër, kompanisë "KAÇINKA" L.L.C me NUI 811389429 nga Ferizaj;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Edhe këtu është e njëjta çështje, e hapi diskutimin:

**z. Betim Shala:** Edhe në këtë rast, përveç pjesës procedurale që nuk pajtohem, a i keni shterë të gjitha mjetet juridike, se po flitet për një kompani serioze, e cila për shkak të luftës në Ukrainë, Bordi i saj në Gjermani, ka vendosur me i ndërprerë punimet jashtë territorit gjerman. Nëse punët e filluar, në këtë rast komuna e Kaçanikut e humbë një investitor shumë serioz dhe mbesin pa punë shumë punëtorë. Me mirë ndoshta është me rishqyrtuar vendimin, me ia zgjatë afatin, sesa me ia ndërprerë kontratën.

**Kryetari i Komunës:** Jo vetëm që i kemi këto vërejtje për 2 kompanitë, por i kam kontaktuar dhe i kam ftuar në zyre të dy kompanitë dhe janë njoftuar me vërejtjet. Ata kanë kërkuar mundësisht kryetar me iu dhënë afat deri në fund të shkurtit apo fillim të marsit, se ishin nja 8-9 kompani që po vendoseshin këtë çështje, ai e ka pas arsyetuar me një leje, pikërisht atë që e

thoni ju, pikërisht para vitit të kaluar. Në momentin që kalon marsi, nuk kam pasur përgjigje se nuk kemi arritur dakordancë. Unë e kam pritur jo marsin, por edhe muajin prill dhe maj me marrë një vendim të tillë. Jo vetëm që iu kam bërë shkresa, por i kam pasur edhe në kontakt edhe kompaninë paraprake, në zyre, bile kompaninë paraprake e kam pasur në zyre nja 7-8 herë, iu kam thënë që me ndërmarrë diçka, duke menduar se mundet me reflektuar diçka, që mos me ardhur deri të kjo çështje që po flasim tani. Pikërisht e kam pasur në zyre edhe kompaninë gjermane, me këta pronarët që janë nga komuna jonë, kështu që i kam shterë të gjitha mundësitë, por nuk ka pasur asnjë reflektim nga ta se paku me ma dërguar një letër, që me kërkuar shqyrtimin e mundësisë për zgjatjen e afatit për 2,3 apo 6 muaj, por nuk kemi pasur asgjë në këtë drejtim nga kompania gjermane. Ky është realiteti, këtë mundemi me dëshmuar apo me kundërshtua kurdoherë që kërkohet diçka në këtë drejtim.

**z. Agim Mani:** Edhe të kjo pikë është e njëjta çështje si në pikën paraprake, fillimisht është dashur me u zhvilluar të gjitha procedurat, pastaj me ardhur çështja në KK, kështu që në LVV nuk do të marrim pjesë në votim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, Propozim Vendimin për shfuqizimin e vendimit të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 14 votë Për (12 nga PDK dhe 2 nga AAK), Kundër votë nuk pati, Abstenuan: Raif Kasa dhe Agim Çaka. Nuk morën pjesë në votim 9 (6 LVV, 3 LDK). Besnik Salihu nuk ishte prezentë kur u votua kjo pikë. Prezent 25. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr.104/02-30658/2020 të datës 29.01.2021 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (40 vite) patundshmërinë në ZK Kaçanik i Vjetër, kompanisë "KAÇINKA" L.L.C me NUI 811389429 nga Ferizaj/ Lënda: 01Nr. 104/02-11633/24.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Tani i kemi raportet e kompanive për realizimin e kontratave, nëse jeni të pajtimit vazhdojmë ose e bëjmë një pauzë. Pasi jeni me vazhduar me mbledhjen, atëherë vazhdojmë:

9. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "MUJA" OP;

Raportin e keni marrë, nëse ka kush diçka, urdhëroni:

**z. Agim Mani:** Unë po e citoj konstatimin e komisionit se "Investitori i ka filluar ti përmbushur pjesërisht zotimet e tija sipas kontratës dhe detyrimet e tija për marrje në shfrytëzim afatgjatë të parcelës komunale për zhvillim ekonomik". Sa i përket raportit, kryetari i komunës thuhet se obligohet që në raportet e tij të rregullta 6 mujore t'i paraqet KK. Kryetari nuk ka raportuar çdo 6 muaj, por çdo vit. Unë e kam një konstatim tjetër, punimet nuk janë duke u zhvilluar sipas planit dinamik, pyetja ime është: Cilët janë hapat që i keni marrë, cilat janë vërejtjet që i keni dhënë, se realizimi i projekteve e ka një limit, a është marrë diçka apo do të vazhdojnë kështu?

**Kryetari i Komunës:** Para 6 -7 muajve, kemi qenë në këtë situatë sikur për 2 kompanitë paraprake, ku ma keni tërhequr vërejtjen dhe me keni thënë çka po pret. Të njëjtën situatë jemi sot për këtë, do t'ia dërgojmë vërejtjen, pastaj do të marrim vendim si për dy kompanitë tjera që u morën sot. E dyta, Agim po thirreni shumë në dinamikë. Në vitin e kaluar i kemi dhënë në shfrytëzim prona komunale nja 2 kompanive. A e dini që ende nuk kanë marrë leje energjetike, ndërkaq punimet kanë pasur me i përfunduar për 1 vit. Qysh me vepruar në këtë

drejtim, kur kompania nuk është fajtor që iu ka vonuar leja që 1 vit, ndërkaq janë 2 fabrika aty. Çështja është e procedurave burokratike që e largojnë nga dinamika e punimeve, e njëjta ka qenë edhe kur janë dhënë në shfrytëzim këto pronat me herët, se ka qenë pandemia, janë bllokuar 1 vit e gjysmë. Kam pasur mirëkuptimin kam bërë shkelje, duke i dhënë mundësinë kompanisë, për atë nuk e kam shikuar dinamikën, as sot nuk e kisha shikuar dinamikën, vetëm me ia arritur qëllimin. Edhe sot kemi me pasur telashe edhe me kompanitë tjera, jo vetëm për fajin e tyre, por për shkak të procedurave burokratike, përkundër vullnetit me investuar, nuk i epët mundësia për shkak se duhet pajiset me leje e pëlqime tjera nga ministria e komuna. Sikurse të kisha vepruar para 6 muajve apo 1 viti, jam i bindur se ma kishit thënë, pse keni vepruar, se ata nuk kishin ende leje energjetike,

**z. Agim Mani:** Nëse raportoni çdo 6 muaj, ne jemi në rrjedha si KK, e kuptojmë se nuk e ka marrë lejen nga ministria, se kjo është mungesë e mbikëqyrjes, por çështja është se duhet me ditur për hapat që do ti merrni.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Hapat janë këto që kanë filluar me u marrë. E dyta, çështja është se është dobësi e kompanive që nuk parashohin në planin dinamik edhe çështjen e plotësimit të dokumentacionit të ndërrimit të destinimit të tokës, marrjen e lejes energjetike, lejes së ndërtimit. Pa i marrë këto leje, kompania nuk mundet me startua me ndërtim, dhe asnjë kompani nuk ka paraparë një kohë të caktuar për këto çështje.

**z. Rrustem Zenuni:** Po kërkoj për hera tjera me u sqarua kompanive, se nëse ndonjë ofertues ka ngecë në realizim të planit dinamik si rezultat i lejeve që u potencuan, ato shqetësime t'na i përcjellin edhe neve në raport, se na i bëni neve me të qarta dhe me të saktë në vendimet që i marrim. Unë nuk kisha dashur që ne të marrim një vendim si rezultat i asaj që nuk janë pajisur me leje përkatëse, kështu që t'na i përcjellin këto që edhe ne të jemi me tolerant. Nuk po e lidh çështjen me rastin e mëparshëm, se kanë dallime të mëdha, por për tjerat.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mosrealizimi i planit dinamik, nuk është arsye për shkak të pandemisë, ndërkaq pengesat që ndodhin në rrafshin tjetër që nuk janë pengesë e jona, ne duhet të jemi të përgjegjshëm t'i pajisim me kohë, ndërkaq mbikëqyrja duhet të jetë më rigoroze me realizuar planin e tyre. Besoj se kemi me pasur raste edhe në të ardhmen me i votuar për apo kundër, sido që të jetë, mbikëqyrja duhet të jetë me e drejtë dhe rigoroze, se disa çështje është më mirë t'i ndalim herët sesa vonë apo kurrë.

**z. Agim Çaka:** Është mirë që janë ardhur këto raporte, se ne i kemi kërkuar vet në KK, është mirë që komisionet të organizuara nga KK të jenë në terren dhe të monitorojnë punën dhe dinamikën e projekteve. Të ky raport, thuhet se investitori ka filluar zbatimin pjesërisht, ndërsa të raportet tjera thuhet i ka përmbushur pjesërisht. A është gabim teknik, se komisioni duhet me konstatuar se i ka përmbushur pjesërisht, nuk i ka përmbushur apo i ka përmbushur plotësisht, ndërkaq ka filluar me i përmbushur pjesërisht, për mua është një shkallë me e ulët se kjo e para. Me intereson me ditur se ky operator, a ia ka nisur punëve apo nuk ia ka nisur hiq, se ky raport dallon në formulim prej raporteve tjera.

**z. Selajdin Troni:** Sa e pash, ky operator, e ka filluar ndërtimin, ndërsa kur e përfundon e ndërron destinimin, atëherë del se e ka ndërruar destinimin.

**Kryetari i Komunës:** Dinamikën e punëve ky investitor e ka 5 vjet.

**z. Agim Çaka:** Konstatimet janë tre, i ka përmbushur pjesërisht, nuk i ka përmbushur dhe i ka përmbushur. Është mirë që po përcjellët puna e tyre dhe po sjellën raportet këtu. Lë ta dinë

edhe ata që kanë me marrë prona tani e tutje, se i përcjellë dikush dhe hartohet raport për punën e tyre.

**z. Agim Mani:** Plani dinamik e kuptuam se është 5 vjeçar, është dashur kontratën me na sjellë neve së bashku me këtë raport, që të dimë se ku ka arritur operatori me realizuar projektin. Një gjë të tillë nuk e keni bërë. Po bazohem në fjalimin e juaj që plani dinamik është 5 vjeçar, operatorit i kanë mbetur edhe 6 muaj në realizimin e planit dinamik, ndërkaq është ende në fazën fillestare. Sesa do t'ia arrijnë, është çështje e tij dhe e mbikëqyrjes së juaj. Nëse nuk realizohet plani dinamik brenda periudhës 5 vjeçare, çka ndodhë?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mosrealizimi i planit dinamik, është shkelje e kontratës. Matja bëhet në atë se a ka devijim të projektit dhe shkelje të kontratës.

**z. Naim Beça:** Të konstatimet, janë vlerësimet e njëjta, të krejt raportet konstatimet e komisionit janë se pjesërisht i kanë përmbushur kushtet. Gjatë inspektimit të punëve sipas kontratës, kush e ka bërë inspektimin e punëve, se këtu nuk është shkruan komisioni, vetëm nënshkrimi, besoj se duhet të shënoj komisioni, se ky është dokument zyrtar dhe mbetet. E dyta, çështja e përmbushjes së kontratës pjesërisht që e potencoj edhe Agimi se disa i kanë përmbushur me tepër disa me pak, ndërsa konstatimi është bërë i njëjtë, se nëse nuk është përmbushur kontrata në tërësi, pavarësisht sa është përmbushur, shkruan pjesërisht. Kjo pjesërisht duhet me u hequr dhe me thënë se është përmbushur kontrata apo nuk është përmbushur, se përndryshe kjo i bien si kamuflazh.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është e shënuar pjesërisht, por të pjesa me poshtë e raportit është sqaruar sesa është përmbushur kontrata.

**z. Qamil Stagova:** Komisioni i ka hartuar disa kritere dhe në bazë të tyre i ka nxjerrë konstatimet.

**z. Agim Çaka:** Të çështja e konstatimeve, duhet me thënë se është në përputhje përmbushja e kontratës me zotimet që i ka dhënë dhe planin dinamik, sepse ka dallim përmbushja e kontratës pjesërisht, me atë që ka filluar me i përmbushur kontratën pjesërisht.

**z. Bashkim Luma:** Për dallim prej raporteve të fundit që i ka sjellë kryetari, është se operatorët kanë pasur afatet e përcaktuara kohore që me i përmbushur obligimet që rrjedhin nga kontrata, ata nuk i kanë përmbushur dhe është vazhduar afati kohor.

**Kryetari i Komunës:** Nuk po mundemi me iu kuptuar, kur po ua shkëpusim kontratën, po thonë pse me ua shkëputur. Ne iu kemi dhënë vërejtje, sepse disa nuk e kanë përmbushur planin dinamik. Pas vendimit të KK, komisioni i ka dhënë krejt këto propozime, operatori e ka afatin 5 vjet. Komisioni me ka dhënë rekomandimin për shkëputje të kontratës, krejt kjo me qëllimin me të mirë, se mos po reflektojnë, se Kaçaniku ka nevojë për investime. Të çështja e planit dinamik, të gjithëve iu kemi dhënë afat, që mos t'ua shkurtojmë rrugën atyre që donë me realizuar një punë të mirë, me iu ndihmuar qytetarëve të komunës, përkundër asaj që po penalizohemi në këtë drejtim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Varësisht sa është barra e shkeljes së kontratës, nëse ka shkelje enorme dhe drastike të kontratës, duhet me vepruar detyrimisht, se ligji rreptësisht e pengon dhe e ndalon tjetërsimin e pronës. Kur ka tjetërsim të pronës, ligji të obligon me marrë veprime sa me shpejt. Diskutime të tjera nuk ka, konstatohet se Kuvendi i Komunës

## NJOFTOHET

**Me Raportin e DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “MUJA“ OP/ Lënda: 01Nr. 06-104/02-11791/24.**

10. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “JLG CONSTRUCTION” SHPK;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ky operator e ka bërë një investim në objekt, ndërkaq ka ngecë në realizimin e planit dinamik, por pasi e ka bërë një investim të madh, besoj se e realizon edhe planin dinamik. Nëse ka kush diçka, urdhëroni:

**z. Agim Çaka:** Të çështja e konstatimeve, është marrë si shabllon, ku thuhet, investitori i ka përmbushur pjesërisht obligimet e kontratës. Në krahasim me disa investitor tjerë që i kam parë në terren, ky i ka përmbushur jo pjesërisht, por shkëlqyeshëm. Këtu ne po duam me bërë dallimin se kush është më mirë, kush është me keq, se nuk mundet komisioni me shkuar kështu shabllon, ku thuhet se ky investitor i ka përmbushur pjesërisht obligimet e kontratës. Ky investitor ka punuar shumë mirë, ne duhet me stimuluar, mundeni me pa vet gjendjen në terren, ndërkaq ndonjë çështje teknike që nuk ka munduar me realizuar, ajo është tjetër. Ky është gabim i komisionit që kur e ka dhënë vlerësimin e përgjithshëm, e kanë dhënë të njëjtë për të gjithë investitorët.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, konstatohet se Kuvendi i Komunës

## NJOFTOHET

**Me Raportin e DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “JLG CONSTRUCTION” SHPK/ Lënda: 01Nr. 06-104/02-11795/24.**

11. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.P “X- PLAST”;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, vlerësimin e keni. Nëse ka kush diçka, lë të urdhëroj;

**z. Agim Mani:** Të çështja ku thuhet se investitori i ka përmbushur pjesërisht detyrime e kontratës dhe detyrimet e tij, kjo është shabllon. Është mirë të analizojmë sesi ofertuesi i ka kryer punimet. Ofertuesi ka filluar me punimet, ofertuesi ka filluar me prodhimin e dyerve dhe dritareve të plastikës, si biznes tjetër. Sa i përket rrobaqepësisë të cilën ofertuesi ka ofertuar, nuk ka arritur që të konkretizoj, ndërsa gjatë inspektimit janë vërejtur vetëm 2 makina të rrobaqepësisë. Ofertuesi ka ofertuar për diçka tjetër, ndërkaq ia ka ndërruar destinimin, kjo nuk është serioze. Ky është konstatim i komisionit dhe nëse deri tani nuk ka arritur me i sjellë makineritë që 4-5 vjet, kjo është e tepruar.

**z. Naim Beça:** Ju kryesues e theksuat se nuk janë të gjitha vlerësimet e komisionit të përmbushja e kontratës pjesërisht. Në krejt raportet që i kanë sjellë, konstatimi i komisionit është se, kontrata është përmbushur pjesërisht.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk e thash ashtu, Po e citoj qysh e thashë; ‘Ka që i kanë realizuar gati plotësisht, ka që i kanë realizuar pjesërisht dhe ka që nuk i kanë realizuar fare’. Pajtohem me mendimin e juaj, se nuk mundemi me i trajtuar krejt njësoj, por sipas realizimit të kontratës.

**z. Naim Beça:** Unë kritikën e kam për komisionin. Edhe herën e kaluar kur ka pasur raporte te tilla, kritika i ka shkuar komisionit. Në raporte ka gabime teknike gjuhësore, emrave e anëtarëve të komisionit duhet me u shënuar, dhe fjala pjesërisht duhet me u hequr.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mirë është me përqindje me u përcaktua realizimi i kontratës. Përshkrimi në raport është ndryshe, ndërkaq vlerësimi i përgjithshëm është pjesërisht.

**z. Selajdin Troni:** Jemi duke kërkuar termin e qëlluar për përmbushje të kontratës. Përderisa nuk është përfunduar krejt objekti, nuk mundemi me ditur se çka ka bërë investitori, kështu që kjo i bien përmbushje e kontratës pjesërisht. Të pjesa e rrobaqepësisë që ka pasur me ndërtuar, në rast se e përmbushë zotimin e rrobaqepësisë, i punëson 30 punëtorë, që shumica janë zotuar për punësim të femrave, nëse ky e shton biznesin edhe për dritare, nuk na prishë punë kjo. Nëse investitori e përmbushë zotimin e kontratës, vazhdon me pjesën e dritareve, çka na pengon kjo.

**z. Agim Mani:** Kontrata duhet me u përmbushur për çka është lidhur, ndërkaq pjesa tjetër duhet me kërkesë tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, konstatohet se Kuvendi i Komunës  
**NJOFTOHET**

**Me Raportin e DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.P "X- PLAST"/ Lënda: 01Nr. 06-104/02-11790/24.**

12.Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.SH.T "LYPETENI";

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush diçka, lë të urdhëroj; Ky e ka realizuar planin dinamik thotë se e ka realizuar planin investiv.

**z. Betim Shala:** Në krahasim me disa investitor tjerë, ky investitor ka realizuar kontratën me mirë sesa do kompani tjera, ky e ka përmbushur shkëlqyeshëm kontratën, ndërkaq çështja e realizimit të kontratës pjesërisht, duhet të specifikohet.

**z. Qamil Stagova:** Komisioni kur ka bërë kërkesë, ka paraparë shkëlqyeshëm vlerësim, por jo shembullor. Pajtohem se kjo kompani ka realizuar kontratën me tepër sesa disa tjera, ndërkaq shembullor nuk është as ky.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komisioni duhet me pasur parasysh mos me dhënë vlerësim të njëjtë për të gjithë. Përshkrimin e kanë bërë mirë për secilën kompani sa kanë realizuar kontratë por konkludimi përfundimtar është i njëjtë. Diskutime të tjera nuk ka, konstatohet se Kuvendi i Komunës

#### **NJOFTOHET**

**Me Raportin e DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.SH.T "LYPETENI"/ Lënda: 01Nr.06- 104/02-11793/24.**

13.Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E njëjta procedurë është edhe të ky raport. Nëse ka kush diçka, urdhëroni. Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës

## NJOFTOHET

**Me Raportin e DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I/Lënda: 01Nr. 06-104/02-11786/24.**

14. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtim të Vendimit 01Nr. 06-350/02-8930/24 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona kadastrale Bob, në emër të Elmaz Mezraja B.I. nga f. Kovaçec;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne i votuam këto vendime që do të arrijmë një çështje që e pengon komunën e Kaçanikut, çështja e ndërtimeve, por është e njëjta përgjigje. Për 2 tjera nuk kam kërkesë nga Ekzekutivi për shfuqizim për shkak se përgjigjet janë kthyer jashtë afatit ligjor. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtoj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 23. Nuk janë prezentë 3 (Besnik Salihu, Florina Lika-Vishi dhe Raif Kasa). Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Për Anulimin e Vendimit 01Nr. 06-350/02-8930/24 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona kadastrale Bob, në emër të Elmaz Mezraja B.I. nga f. Kovaçec/ Lënda: 01Nr.104/02-12459/24.**

15. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtim të Vendimit 01Nr. 06-350/02-8928/24 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona kadastrale Bob, në emër të "Dream Palace" SH.P.K. nga Ferizaj, me përfaqësues Avni Etemi;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Edhe të kjo, përgjigja është e njëjtë. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Kjo pikë dhe pika paraprake janë të natyrës së njëjtë. Ne, në mbledhjen kur është marrë ky vendim, kemi qenë kundër, për shkak që mos t'ia pamundësojmë operatorit me ia mbyllë dyert. Për atë, fillimisht duhet palës t'i japim këshilla profesionale sesi me vepruar, me i kompletuar dokumentacionet, e jo tani me marrë një vendim, pastaj e shfuqizojmë atë vendim, duke u kthyer në pikën zero.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Operatori në disa raste ka qenë në rregull, por ne nuk jemi në rregull në disa punë, nuk jemi në rregull me PZHK, se ato prona PZHK nuk i parasheh si toka ndërtimore. Nuk është çështja se operatorin e ka quajtur dikush keq apo mosplotësim të dokumentacionit, por çështja është mospërputhje me PZHK, ndërkaq dyert nuk i mbyllën operatorit, se në momentin që kemi PZHK të ri dhe nëse trajtohet ajo parcelë me PZHK, operatorët i kanë dyert e hapura për investime, por ne jemi vonuar shumë në këtë çështje. Diskutime tjera nuk ka, kjo pikë u shtrua në votim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 23. Nuk janë prezentë 3 (Besnik Salihu, Florina Lika-Vishi dhe Raif Kasa). Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Për Anulimin e vendimit 01Nr. 06-350/02-8928/24 i datës 29.04.2024 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore zona kadastrale Bob në emër të "Dream Palace" Sh.P.K. nga Ferizaj me përfaqësues Avni Etemi / Lënda: 01Nr.104/02-12456/24.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Fjalën në fund ka me marrë Fitore Vishi, për një çështje që e ka kërkuar me herët, megjithatë urdhëroni Naim Beça:



**z. Naim Beça:** Kam vërejtje për kushte teknike të sallës, si aromë e keq nga tepihu, vapë e madhe në sallë mbi 30 gradë, ndërkaq kërkoj nga zyrtarët përgjegjës të marrin veprime të nevojshme që për mbledhje tjera të krijohet ambient i mirë për punë në sallën e KK, se ky ambient kështu siç është, ndikon keq në shëndetin tonë.

**znj. Fitore Vishi:** Para se të deklaroj dorëheqjen time nga KK, dua të shprehi mirënjohjen time të thellë dhe falënderime për PDK –dega në Kaçanik, si dhe votuesit e mi, në zgjedhjet e fundit të cilët më dhanë besimin të jem njëra nga përfaqësuesit e tyre në institucionin vendimmarrës në komunën tonë. Po ashtu shprehi dëshirën që për punën kolegjiale e partiake të grupit të PDK në këtë KK, t'i falënderoj për bashkëpunimin e ngushtë dhe përfaqësimin sa me dinjitoz të zërit dhe interesit të gjithë qytetarëve të komunës tonë pa asnjë dallim. Një falënderim i veçantë shkon për Kryetarin e komunës -Besim Ilazi dhe Kryesuesin e KK- Kemal Murseli. I falënderoj të gjithëve që jeni këtu, për punët e mira e më mirëkuptim që kemi bërë deri sot. I nderuar kryesues i KK, të nderuar kolegë e kolege, për shkak të kalimit tim në një detyrë të re, me duhet të deklaroj dorëheqjen time. Zotohem se edhe në detyrën e re me konsekuencë dhe ndershmëri të lartë në kryerjen e të gjitha detyrave të punës. Juve iu uroj suksese tjera në vazhdim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Faleminderit Fitore, edhe juve iu urojmë suksese në emër të gjithëve këtu, që mos t'ia japim fjalën secilit. Urime në detyrën e re.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 14:05. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 23, ndërkaq me herët dolën nga mbledhja: Besnik Salihu, Florina Lika –Vishi, Raif Kasa.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

*Malsiu*

